



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXI-të (njëzetënjë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 08 maj 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK, Blerim Vllasa zyrtar në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Podujevës; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE, Par Tamas përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë dhe kjo mbledhje siç jeni në dijeni është thirrë për datën 06.05.2023 mirëpo meqë ajo ditë ka qenë ditë pushimi për shkak të Festës Zyrtare, mbledhja është shtyrë për sot, pra për datën 08.05.2024 dhe sigurisht jeni njoftuar të gjithë përmes e-mailit që ju është dërguar, andaj në vazhdim po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 9 vota Për, nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Informatë nga Drejtoria e Arsimit rreth parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në arsimin e obliguar.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditë kemi ftuar Drejtorinë e Arsimit për të na jap sqarime dhe informatat e nevojshme rreth kësaj teme, andaj prezent këtu e kemi zyrtarin e kësaj Drejtorie i cili mund ta merr fjalën.

z.Blerim Vllasa, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit-DKA në Komunën e Podujevës, në pika të shkurtra e paraqiti informatën në fjalë, theksoi, sipas informatave zyrtare që kemi në Drejtorinë e Arsimit dhe që informohemi nga drejtorët e shkollave në kuadër të punëve të përditshme që kemi ne si DKA dhe si Ekip komunal kundër braktisje së nxënësve nga shkollimi, me vendim të drejtorit të DKA në fund të muajit tetor 2023 është formuar edhe një Grup punues i cili ka

përgatitur një Plan të veprimit i cili besoj se në mbledhjen e radhës do t'i prezantohet edhe Kuvendit të Komunës, që është një Plan i veprimit kundër braktisjes në shkolla dhe është hartuar nga Ekipi komunal në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, është edhe një vlerë financiare e cila parashihet për 3 vitet e ardhshme si dhe hapat që do të ndjekën për zbatimin e këtij Plani ndaj fëmijëve që kanë tendencë të braktisjes së shkollimit e që besoj se shumë shpejt edhe Kuvendi i Komunës do ta trajtoj me prioritet dhe do ta miratoj si Plan final.

Sa i përket braktisjes së mësimin nga periudha prej mbledhjes së fundit që kemi qenë në këtë Komitet e deri më sot, nuk kemi ndonjë informatë zyrtare që ndonjë fëmijë e ka braktisë mësimin, përveç ndonjërit që zyrtarisht ka emigruar apo që ka ndërrua vendbanim.

Një rast e kemi tek shkolla “Hyzriu e Samiu” për të cilin jemi informuar nga drejtoresha e shkollës e që tani këtu prezent e kemi edhe sekretaren e shkollës znj.Qëndresë Hajrizi e cila mund të na informoj më gjerësisht, unë e kam marrë numrin e telefonit të prindit të tij dhe kam biseduar me të i cili na ka njoftuar se fëmija ka pas disa probleme shëndetësore dhe është zotuar që fëmija i tij do të kthehet në shkollë, rast për të cilin kam biseduar edhe me drejtoreshën e shkollës dhe nga ajo kam kërkuar që të përcillet ky rast dhe të informohemi vazhdimisht ne si DKA. Kështu që në përgjithësi situata është e qetë dhe nuk kemi ndonjë informacion për ndonjë braktisje të shkollimit në këtë periudhë kohore.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, vetëm dua ta informoj zyrtarin e DKA-së z.Blerim Vllasa rreth rastit të braktisjes së shkollimit nga nxënësi në fjalë, ai nxënës është kthyer dhe për momentin është duke e vazhduar procesin mësimor, mirëpo se sa do të vazhdoj dhe a do ta vazhdoj tani për tani nuk mund të themi asgjë. Nxënësi në fjalë nuk është nga komuniteti jo shumicë.

z.Blerim Vllasa, zyrtar në DKA, theksoi, e vërtetë se ai nxënës nuk i përket komunitetit jo shumicë, përndryshe në shkollat ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë, sipas raporteve të drejtorëve të shkollave nuk kemi ndonjë informacion për ndonjë nxënës që mund ta ketë braktisur shkollimin.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Komuna e Podujevës gjithëherë ka qenë e kujdesur në këtë aspekt, nuk kemi pas rast të braktisjes së shkollimit nga ndonjë nxënës i komuniteteve jo shumicë sa unë jam i informuar, mund të ketë ndonjë rast por unë nuk e di dhe nuk jam i informuar nga kontaktet e rregullta që kam me përfaqësues të lagjeve dhe familjeve të ndryshme të komunitetit jo shumicë, pra për momentin nuk ka ndonjë nxënës përveç ndonjë nxënësi që mund të ketë shkuar jashtë vendit, për shumë këtu anëtar në këtë Komitet kemi nga të gjitha lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë dhe mund të na informojnë secili prej tyre për lagjet e tyre. Pra kemi pas fatin që sa i përket arsimit nuk kemi pas ndonjë problem të theksuar, për çka falënderoj shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri, Drejtorinë komunale të Arsimit dhe gjitha Drejtoritë dhe organet tjera relevante që janë angazhuar gjithëherë që komuniteti jo shumicë në Komunën e Podujevës të jetë në nivelin e duhur, por që një gjë është e mirë që tani edhe komuniteti jo shumicë është vetëdijësuar dhe fëmijët e tyre po i dërgojnë me kohë në regjistrim.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, deshta të parashtrij pyetje rreth funksionimit apo jo të Qendrës për Aftësim Shtesë në shkollën “Shaban Shala”, a janë duke vijuar procesin nxënësit e komuniteteve jo shumicë në atë qendër apo jo.

Para dy viteve ka qenë funksionale ajo Qendër dhe kanë ardhur nxënësit e komuniteteve jo shumicë nga shkolla “Naim Frashëri”, mirëpo tani meqë nuk ka të punësuar nga komunitetet jo shumicë nuk e di a është funksionale dhe a vijojnë nxënësit mësimin shtesë në atë Qendër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me atë që parafolësja e ngriti është mirë që u ngrit, pengesa kryesore ke qenë ti (i drejtohet znj. Sevdije Mustafa) dhe ti ke qenë ajo që ke humbë Qendrën për Aftësim Shtesë sepse nuk ke shkuar t'i nënshtrohesh provimit, kështu që ajo Qendër ka dështuar kryesisht për shkakun tuaj, prandaj përgjegjësinë për mos funksionimit të Qendrës e ke ti e nderuar, madje ti ke qenë shumë e pa interesuar në lidhje me atë Qendër në kohën kur ke qenë aty dhe kur kanë ngelë nxënësit e komuniteteve jo shumicë, andaj në lidhje me këtë kemi marrë vendim në komunitet / në lagje që ti tani e tutje të zëvendësoheni dhe ta gjejmë një zëvendësues tuajin, një mësues/e të aftë dhe që angazhohet si dhe që i kryen obligimet e veta.

Unë kam dëgjuar që ti zonja Mustafa je punësuar diku dhe jeni duke punuar prandaj edhe qendrën e cekur paksa e ke neglizhuar, mirëpo në vitin e ardhshëm gjithsesi na duhet ta funksionalizojmë Qendrën e Aftësimit Shtesë dhe atë me ndihmën e DKA-së e cila na e ka mundësuar për çka e falënderojmë shumë, përndryshe në këtë vit ajo Qendër ka dështuar.

Pra kjo është e vërteta, mirëpo në vitin e ardhshëm na duhet ta ngrisim atë Qendër sepse pa të nuk mund të ngrisim cilësinë e arsimit dhe të kemi sukses në shkollim, të paktën për fëmijët e komuniteteve jo shumicë.

znj. Sevdije Mustafa, theksoi, në këtë aspekt mendoj se është mirë të merren parasysh edhe gjërat personale që kemi secili, pra konkretisht shëndetin e dikujt sepse nuk kam mundur të shkoj në test për shkak se kam pas probleme shëndetësore, andaj nuk e shoh veten fajtores përse nuk kam mundur të shkoj në testim për mësimdhënie në Qendrën e Aftësimit Shtesë, prandaj një situatë të tillë duhet ta kuptoj çdo kush sepse nuk ka qenë arsyeja pse unë nuk kam dashtë të shkoj në test ngase po të mos doja nuk do të aplikoj fare.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e nderuar, gjithë atë zhurmë që e kemi bërë këtu dhe gjitha iniciativat e veprimet që i kemi marrë për atë Qendër, ka qenë jashtëzakonisht e madhe andaj nuk dëshiroj tani të hyjë në polemika tjera me askënd, veçse gjithë këta që janë këtu por edhe të tjerë janë angazhuar për funksionalizimin e kësaj Qendre dhe në fund nuk ka ardhur, andaj kjo çështje tani më është e mbyllur për këtë vit.

znj. Sevdije Mustafa, theksoi, atëherë përse nuk merren nxënësit e komuniteteve jo shumicë nga shkolla "Shaban Shala" e të dërgohen në shkollën "Naim Frashëri" meqë mësuesja përkatëse është në atë shkollë, sikurse që unë i kam marrë nga shkolla "Naim Frashëri" kur kam qenë mësuese në shkollën "Shaban Shala" e që në atë kohë as nuk ka pas braktisje të nxënësve e as mungesa dhe probleme tjera të ngjashme, si dhe sukcesi ka qenë shumë më i mirë në atë kohë, ndërsa tani lirshëm mund të shkoni dhe t'i vizitoni shkollat dhe të shihni sa shumë mungesa kanë nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe çfarë sukcesi kanë. I them këto sepse kam informata.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, faji mund edhe të mbetet jetim si thuhet në popull, mirëpo unë po e them edhe njëherë se faji është posaçërisht tek ti e nderuar Mustafa. Nuk ka kush t'i bëjë ato gjëra dhe ti ke qenë ajo që ke bërë atë punë dhe ti je ke qenë ajo që je marrë me nxënësit në atë qendër, prandaj unë nuk di çfarë të them tjetër rreth kësaj teme.

z. Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, edhe pse debati paraprak ndoshta mund të zhvillohet ndokund tjetër dhe atë mes juve, por sërish e konsideroj si gjë të mirë që u sqaruat tani. Në këtë aspekt falënderoj shumë DKA-në e cila ka bërë çmos për ta funksionalizuar atë Qendër sikurse që e falënderoj edhe OSBE-në për trajnimin e organizuar rreth shfrytëzimit dhe shpenzimit të mjeteve financiare për Qendrat e Aftësimit Profesional dhe dëshiroj ta mbyll këtë temë me thirrjen që shkaktarët e mos funksionalizimit të saj në këtë vit duhet të jenë shumë më aktiv në mënyrë që Qendra të funksionalizohet dhe të vazhdoj punën ngase është përfitim i madh edhe i Komunës së Podujevës por përfitim i madh është enkas për komunitetin jo shumicë qoftë për

punësim, zhvillim, arsimim dhe gjitha format tjera që në të ardhmen të mund ta zgjidhni një problem si komunitet jo shumicë që jeni.

Sa i përket temës, dëshiroj t'ju jap një statistikë se në vitin e kaluar kanë qenë 5 raste të nxënësve të komuniteteve jo shumicë, por me intervenimin tonë për çka e falënderoj edhe koordinatoren e Ekipës për mos braktisje të nxënësve nga procesi shkollor që është z.Blerim Vllasa zyrtar i DKA, Ekip në të cilin jemi edhe unë edhe Kryesuesi i këtij Komitete por edhe anëtar tjerë relevant, pra kemi arritur t'i kthejmë nxënësit sërish në proces arsimor në shkolla të ndryshme që kanë qenë.

Bazuar në statistikat që unë i siguroj drejtpërdrejtë në shkolla, në shkollën “Naim Frashëri” në Podujevë janë 78 nxënës prej tyre 35 vajza dhe 43 djem, pastaj në shkollën “Shaban Shala” në Podujevë janë 8 nxënës prej tyre 4 vajza dhe 4 djem, në shkollën “Dr. Ibrahim Rugova” në Podujevë janë 72 nxënës prej tyre 36 vajza dhe 36 djem, mandej në shkollën “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan janë 8 nxënës prej tyre 5 vajza dhe 3 djem, në shkollën “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë janë 8 nxënës prej tyre 2 vajza dhe 6 djem, në shkollën “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël janë 5 nxënës prej tyre 3 vajza dhe 2 djem, pastaj kemi shkollat e mesme të larta në Podujevë ku në shkollën ekonomike kemi 14 nxënës prej tyre 4 vajza dhe 10 djem dhe në shkollën “Fan S.Noli” janë 2 nxënës djem.

Pra gjithsejtë kemi 179 nxënës të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës të cilët ne aktivisht i kemi përcjellë sa i përket gjendjes së tyre dhe mos braktisjes së procesit të shkollimit obligativ e që kemi edhe 10 nxënës në sistemin parashkollor dhe 16 nxënës në shkollimin e mesëm të lartë, si dhe në Universitet kemi 3 studente e që njëra prej tyre është edhe pjesë e këtij Komitete, do të thotë ne si Komunë dalim mirë në kuptimin e shkollimit sa i përket komuniteteve jo shumicë e që gjithëherë i kemi përcjellë dhe ju kemi dhënë prioritet të veçantë që është shtylla kryesore Arsimit.

Nëse analizojmë dhe krahasojmë këto statistika me ato të menjëherë pasluftës ku ka qenë një numër krejt simbolik i nxënësve të komuniteteve jo shumicë që kanë vijuar shkollimin, dhe tani nëse po ashtu krahasojmë edhe numrin e popullsisë në Komunën e Podujevës del të jetë numër i kënaqshëm i nxënësve të komuniteteve jo shumicë që regjistrohen dhe që vijnë shkollimin, edhe pse ndoshta nuk mund të jetë i kënaqshëm në shkolla të larta dhe në Universitet por që vazhdimisht ky numër vie duke u rritur sepse tani është rritë edhe vetëdijesimi i tyre dhe shembull kur shohim se në shkollën ekonomike nxënësit e komunitetit jo shumicë janë prej nxënësve më të mirë në shkollë, prej tyre 10 vajza dhe 4 djem, e kur shohim që edhe numri i vajzave është në rritje, për neve është inkurajim si fakt.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, vlen të theksohet se të gjithë nxënësit e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës ë cilët vijnë shkollimin në shkollat e mesme marrin bursën.

Gjithashtu sa për njoftim e juaj një studente e komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës e cila vijon studimet në Universitet ka notën mesatare 9.5 e cila besoj se do të jetë perspektivë bukur e madhe, kështu që jemi të gëzueshme për këtë ne si komunitet jo shumicë.

znj.Fikmete Qurkollli, theksoi, në shkollën “Naim Frashëri” në Podujevë nxënësja e komuniteti jo shumicë Miradije Lahu ka rreth 1 muaj që ka braktisur shkollimin ku ishte duke vijuar procesin mësimor në klasën e VIII-të.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për rastin e nxënësës së cekur ne kemi qenë të njoftuar edhe më parë që e ka braktisë shkollimin por që bashkërisht të gjithë kemi intervenuar dhe ajo nxënëse është kthyer dhe ka vijuar procesin mësimor.

z.Liman Zeqiri, theksoi, pajtohem me Kryesuesin se për rastin në fjalë kemi intervenuar më parë dhe kemi arrite që ta kthejmë në procesin mësimor, mirëpo për braktisjen e serishme tani po

njoftohemi e që sigurisht se do të ndërmarim veprime që e përmendura sërish të rikthehet dhe të vijoj procesin mësimor aty ku ka mbet.

znj.Fikmete Qurkolli, vazhdoi, po ashtu dua të cekë se znj.Bukurie Sejdiu është arsimtare e lëndës Edukimi Shoqëror, e cila disa nxënësve të klasës së VI-të vazhdimisht i'u thotë se do t'i ngelë prandaj për atë arsye ata nxënës nuk po dëshirojnë të marrin pjesë në atë lëndë / orë mësimi.

Po ashtu në atë shkollë është një arsimtar i lëndës Art i cili e ka emrin Agim kurse mbiemrin nuk e di, por që ai arsimtar e përdor shumë fjalën “magjup” e që nxënësit e komuniteteve jo shumicë nuk po dëshirojnë të hyjnë në orën e tij, ndërsa po të shikosh, nga komuniteti jo shumicë shembull ta zëm vajza ime është nxënësja më e mirë në lëndën Art.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këto dhe shumë çështje tjera kemi planifikuar t'i vizitojmë shkollat dhe të shohim nga afër procesin mësimor të nxënësve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar dhe kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

2. Analizë e realizimit të planit të punës së Komitetit për Komunitete për tremujorin e parë të vitit 2024, dhe caktimin e datave për vizitat në vendbanimet ku jetojnë komunitet jo shumicë në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, për punën që kemi bërë gjatë këtyre tre muajve si Komitet për Komunitete, ndër të tjera kemi pasë Informatën e shefit zyrtar të komiteteve për kthim në Drejtorinë Regjionale ku kemi bërë një rezyme dhe kemi shikuar ku janë pranuar 10 punëtor nga komuniteti jo shumicë në Pastrim ku kemi dhënë kontributin dhe ndihmën edhe ne si Komitet për Komunitete për çka falënderoj të gjithë por falënderim të veçantë kam për Kryetarin e Komunës i cili ka intervenuar dhe është bërë një punësim për 10 familje të komuniteteve jo shumicë, pra mund ta konsiderojmë edhe një rezultat tonin në këtë tremujor.

Gjithashtu kemi edhe raportin tremujor të ZKKK-së ku janë paraqitur të gjitha nga shefi i kësaj zyreje z.Liman Zeqiri, pastaj kemi pasë Informatën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku kemi biseduar rreth projektit për shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjellësit dhe jemi informuar në detaje duke u informuar edhe se çfarë të veprojmë tutje, si dhe kemi biseduar rreth projekteve, kërkesave dhe nevojave të komuniteteve jo shumicë dhe na është sugjeruar çfarë të bëjmë ne si komunitet që të identifikojmë dhe të paraqesim kërkesat dhe nevojat tona për investime në këtë vit, kështu që jemi në përgatitje e sipër të kërkesave që do t'i paraqesim për projekte të ndryshme në Komunën e Podujevës.

Gjithashtu në këtë pikë kemi edhe caktimin e datave të vizitave nëpër shkolla dhe lagje ku jetojnë komunitete jo shumicë në Komunën e Podujevës.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, mendoj se do të ishte mirë që në lagjen ku jetoj unë në rr.”Xhafer Meta” vizita të bëhet në këtë muaj ngase kemi edhe regjistrimin e nxënësve në shkolla por kemi edhe regjistrimin e popullsisë që është një proces mjaft i rëndësishëm.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kam propozim që në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.”Xhafer Meta” vizitën ta organizoj znj.Shkurte Sejdiu për arsye se unë jam shumë i zënë dhe nuk di a mund apo jo të dal në vizitë për shkaqe familjare. Pra e përmendura së bashku me anëtarët tjerë të këtij Komiteti dhe me shefin e ZKKK-së z.Liman Zeqiri të dalin në terren, të vizitojnë familjet e komuniteteve jo shumicë në atë lagje dhe të shikojnë kërkesat dhe nevojat e

tyre duke përfshirë edhe procesin e regjistrimit të popullsisë si dhe vijueshmërinë e nxënësve në procesin mësimor apo eventualisht ndonjë braktisje nga shkollimi, theks i veçantë t'i jepet regjistrimit të nxënësve në shkolla sepse tani është koha e regjistrimit të tyre, prandaj të inkurajohen prindërit t'i regjistrojnë në shkolla, përndryshe të mos ankojemi pastaj për mos regjistrim në shkolla sepse pastaj në momentet e fundit Drejtoria e Arsimit nuk po mund t'i regjistroj dhe t'i sistemoj ata nxënës, e që do të ishte mos përgjegjësi e jona si komunitet jo shumicë që jemi.

Andaj urdhëroni mund të diskutojmë dhe të japim propozime rreth vizitave të planifikuara në shkollat dhe lagjet ku vijojnë procesin mësimor dhe ku jetojnë komunitetet jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, propozim i imi rreth vizitave është që në një datë të përfshihen 2-3 shkolla apo lagje ku jetojnë dhe vijojnë mësimin komunitetet jo shumicë. Shembull në rajonin e Orllanit dhe të fshatit Sfeçël brenda një dite mund t'i vizitojmë e që mund të marrim pjesë të gjithë anëtarët e këtij Komiteti si dhe unë si shef i ZKKK-së në mënyrë që njoftohemi me gjendjen e tyre faktike por edhe për faktin që në këtë kohë është edhe regjistrimi i popullsisë por edhe çështja tjetër që tani në muajt e ardhshëm është edhe rishikimi i buxhetit andaj mund të paraqiten kërkesa dhe nevoja të ndryshme nga komunitetet jo shumicë e të cilat pastaj sipas nevojave dhe mundësive mund të hyjnë në kuadër të projekteve për realizmin e tyre në pjesën e dytë të këtij viti.

Pastaj në një ditë tjetër mund t'i vizitojmë tri shkollat në Podujevë (*Shaban Shala, Naim Frashëri dhe Dr.Ibrahim Rugova*).

Pra të caktohen datat e vizitave, vendtakimi dhe ora, sepse kërkohet edhe përgatitjet dhe organizimi qoftë i transportit e të tjera të ngjashme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi,

Pas diskutimeve dhe propozimeve të dhëna, si përfundim përkrahet që:

-Më datë 13 maj 2024, të vizitohet lagja ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Xhafer Meta" si dhe shkolla ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë "Dr Ibrahim Rugova" në Podujevë.

-Më datë 14 maj 2024, të vizitohet lagja ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" si dhe shkollat ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë "Shaban Shala" dhe "Naim Frashëri" në Podujevë.

-Më datë 15 maj 2024, të vizitohen lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë në fshatrat Orllan, Batllavë dhe Sfeçël, si dhe shkollat ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë në këto fshatra.

Për vizitat e sipërpërmendura, takimi i anëtarëve të bëhet këtu në hapësirat e jashtme të Komunës dhe atë në ora 9:00. Për çdo çështje ne mund të komunikojmë edhe përmes telefonave.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, këto vizita janë shumë domethënëse sepse shohim nga afër të gjitha çështjet, problematikat, nevojat, kërkesat dhe shqetësimet e komuniteteve jo shumicë, andaj mendoj se është mirë të jenë prezent të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, varësisht mundësive gjithnjë.

Sa i përket shqetësimit që e paraqiti anëtarja e këtij Komiteti znj.Fikmete Qurkolli, e që mua personalisht më preku shprehja e cekur, ne e kemi hartuar dhe miratuar Planin e veprimit për mos diskriminim si dhe janë organet kompetente të cilat merren me çështjet e cekura siç është njëra prej tyre Drejtoria e Arsimit dhe në qoftë se ai arsimitar është shprehur në atë mënyrë siç u cek, mund të verifikohet dhe të veprohet pastaj, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodh asnjëherë n

Komunën e Podujevës dhe atë e them nga përvoja ime 23 vjeçare në Komunën e Podujevës dhe në këtë zyrë që punoj me komunitetet jo shumicë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, rreth çështjes së ngritur për termet e përdorura në klasë siç e ceku anëtarja e këtij Komiteti pak më parë, unë pajtohem me z.Liman Zeqiri se në Komunën e Podujevës asnjëherë nga paslufta nuk ka ndodh që të përdoren termet të tilla dhe të ketë ndonjë diskriminim ndaj nxënësve të komunitetit jo shumicë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konstatoj të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës dhe njëkohësisht këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-002994/24
Podujevë, 08 maj 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**